

**Cross-Border Cooperation Programme Montenegro - Kosovo* 2014-2020 under the Instrument for
Pre-Accession Assistance (IPA II)**

**EuropeAid/171521/ID/ACT/MULTI
Ref: PREA/07-2023**

UDHËZUES - THIRRJE PËR APLIKIM

**TOURISM FOR FUTURE
ÇERTIFIKIMI ECO-LABEL – MENAXHIMI I TURIZMIT TË
QËNDRUESHËM
2023-2025**

PËR MË SHUMË INFORMACIONE:

Linku: <https://tourismforfuture.com/>

BACKGROUND

Prishtina REA, në bashkëpunim me Institutin IPER, komunën e Kolashinit dhe Shoqatën Gjeravica nga Peja, po implementojnë projektin "**Tourism for Future**", i mbështetur nga Programi për Bashkëpunim Ndërkufitar Mali i Zi-Kosovë, nën Instrumentin për Asistencën e para-afritit (IPA II), duke synuar, ndër të tjera, ofrimin e mbështetjes për bizneset nga turizmi (entitete akomoduese) nga rajoni i Pejës dhe Kolashinit drejt vlerësimit, promovimit dhe praktikimit të kulturës së re të punës të standardeve të eko-zhvillimit dhe certifikimit me standardin ndërkombëtar EU Eco Label.

Certifikimi me Standardin ECO-LABEL– si mjet i Menaxhimit të Turizmit të Qëndrueshëm fokusohet kryesisht në:

- i) Infrastruktura (energji, uji, mbeturinat),
- ii) Mjedis,
- iii) Trashëgimia Kulturore,
- iv) Furnizimi lokal/agro-ushqimor,
- v) Kapaciteti i menaxhimit të turizmit i njohur si vlerat e eko-turizmit.

OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM (d.m.th. ndikimet/impakti) i projektit është të kontribuojë në zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm ndërkufitar përmes rrjeteve, duke prezantuar standardet green key dhe eko, përmirësimit të konkurrencës dhe promovimit të përbashkët.

Ndërsa, ndikimi/impakti është promovimi i pjesëmarrjes së NMVM-ve që synojnë sistemet e certifikimit të BE-së, në veçanti, Ecolabel-in e BE-së dhe EMAS që synojnë përshtatjet e kriterëve përbushëse të nevojshme për të kërkuar skema certifikimi përkatëse dhe të arritshme, e të njohura ndërkombëtarisht.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE TË THIRRJES PËR APLIKIM

- Të rritet numri i bizneseve nga turizmi të certifikuar me eco-label në rajon.
- Të përmirësojë praktikën e qëndrueshmërisë mjedisore dhe sociale të entiteve akomoduese.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e turistëve dhe industrisë për përfitimet e turizmit të qëndrueshëm nëpërmjet certifikimit Eco-label.

QËLLIMI

Tourism for Future, është një adresë reale ndaj sfidave të kapaciteteve të menaxhimit të turizmit, veçanërisht në drejtim të menaxhimit efektiv, të qëndrueshëm, procesit të standardeve ndërkombëtare, miqësore me mjedisin, turizmin dhe komunikimit të integruar ndër-rajonal, si dhe trashëgimisë kulturore, komunitetit dhe shpirtit tradicional, duke përfshirë rrjetet dhe bashkëpunimin ndërkufitar. Konsiderohet më tepër si mungesë kapacitetesh menaxhuese të burimeve njerëzore dhe mungesë interesi për rritjen e kulturës së standardeve ndërkombëtare, për shkak të mungesës së ndërtimit të burimeve njerëzore strategjike në turizm dhe vizionit të qartë.

Logjika e ndërhyrjes së projektit promovon **zgjdhje ndërkufitare që synojnë turizmin e qëndrueshëm**. Masat e identifikuar të rëndësishme për këtë sektor janë:

Rritja e kapaciteteve të menaxhimit të hotelit, entiteteve akomoduese, restoranteve, agro-ushqimit dhe atij kulturor për **Çertifikimin mestandardet Ndërkombëtare, green key dhe Eco-Label në menaxhimin e turizmit**

Nisma, një praktikë e përshtatur evropiane, synon të promovojë standardin Eco label dhe menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit, të rrisë aftësitë e kapaciteteve të tyre të mbrendshme, dijet, vlerat, transferimin e të mësuarit dhe mentalitetin e menaxhimit, të cilat, me konsolidimin e pronësisë lokale, do të jenë në gjendje t'i administrojnë dhe të marrin certifikimin me standardin Eco Label përmes auditimit ndërkombëtarisht të njohur akreditues.

Për të promovuar këtë aktivitet, **Tourism for Future**, ka hapur thirrjen e Aplikimit për Çertifikimin me Standardet Eco-Label, duke synuar industrinë e hoteleve dhe akomodimit, me qëllim të grantimit së përfituesve të zgjedhur nga të dy rajonet e synuara ndërkufitare dhe zbatimin e Çertifikimeve me Standardin Eco-Label për subjektet e hotelerisë dhe akomodimit.

APLIKANTËT E PRANUESHËM

Për t'u kualifikuar, aplikantët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Aplikanti është një person aktiv biznesor individual ose juridik, i themeluar sipas Legjislacionit në fuqi për Shoqëritë Tregtare në Ministrinë përkatëse dhe i themeluar në:
 - në Kosovë: Pejë, Istog, Deçan ose Mali i Zi: Kolashin, Beranë, Rozhajë
 - NMVM-të që punojnë në sektorin e turizmit që kanë të paktën 2 dhoma, idealisht që demonstron ose synojnë inovacion në turizëm, që operojnë brenda kategorive të mëposhtme, në përputhje me këto kode aktivitetesh sipas Eurostat-it2:

55 Akomodim

55.1 Hotele dhe akomodime të ngjashme

55.10 Hotele dhe akomodime të ngjashme 5510*

55.2 Pushimore dhe njësi akomoduese të tjera për qëndrime të shkurtra

55.20 Pushimore dhe njësi akomoduese të tjera për qëndrime të shkurtra 5510*

55.3 Kampet, parqet rekreative akomoduese me kamp-shtëpiza

55.30 Kampet, parqet rekreative akomoduese me kamp-shtëpiza 5520

55.9 Njësi Akomoduese të tjera (bujtina, guest-house, villa, shtëpi malore turistike etj)

55.90 Njësi Akomoduese të tjera (bujtina, guest-house, villa, shtëpi malore turistike etj)

ARSYET PËR PËRJASHTIM

Aplikimet nuk do të konsiderohen për grant nëse aplikantët janë në ndonjë nga situatat e mëposhtme:

- Veprimtaria e aplikantit/kompanisë duhet të jetë në përputhje me legjislacionin kombëtar mjedisor.
- Aplikanti duhet të konfirmojë në projekt propozimin se aktiviteti i tyre nuk ka një efekt negativ në mjedis.
- Aplikanti nuk duhet të ketë asnjë dënim për sjellje mashtruese, parregullsi të tjera financiare, praktika biznesi joetike ose të paligjshme;
- Aplikanti nuk është shpallur i falimentuar apo ka nisur procedurat e falimentimit;
- Aplikanti nuk është në likuidim ose nuk është ndërmarrje në vështirësi sipas Rregullores së

Komisionit Nr. 651/2014, neni. 2.18;

- Aplikanti nuk përjashtohet nga mundësia e marrjes së fondeve të BE-së sipas dispozitave të ligjit kombëtar dhe atij të BE-së, ose me vendim të autoritetit kombëtar ose të BE-së.
- Nëse një aplikant merr pjesë në një thirrje tjetër të hapur të financuar/bashkëfinancuar nga fondet e BE-së për të njëjtën kërkesë, financimi i dyfishtë i aktiviteteve të njëjta ose të ngjashme nuk lejohet.

Po ashtu edhe:

- Janë të falimentuar ose të mbyllur, punët e tyre administrohen nga gjykatat, kanë lidhur marrëveshje me kreditorët, kanë pezulluar biznesin.
- Ata janë dënuar për një vepër penale në lidhje me sjelljen profesionale me një aktgjykim që ka fuqinë e “res judicata”.
- Ata kanë qenë fajtorë për shkelje të rënda profesionale të vërtetuara me çdo mjet që autoriteti kontraktues mund ta arsyetojë.
- Ata nuk kanë përmbushur detyrimet në lidhje me pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore ose pagesën e taksave në përputhje me dispozitat ligjore të vendit në të cilin janë themeluar ose me ato të vendit të autoritetit kontraktor ose ato të vendit ku kontrata duhet të kryhet.
- Ata kanë qenë objekt i një vendimi që ka fuqinë e të gjykuarit për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale ose ndonjë veprimtari tjetër të paligjshme.
- Ata përballen me një konflikt interesi.
- Ata janë fajtorë për keqinterpretim në dhënien e informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor si kusht për pjesëmarrje në procedurë ose nuk e japin këtë informacion.
- Aplikantët duhet të ofrojnë dëshmi se nuk janë në një nga situatat e mësipërme.
- Për këtë qëllim, aplikantët duhet të dorëzojnë një deklaratë për nderin e tyre si pjesë e formularit të aplikimit.

KRITERET E PËRZGJEDHJES

Aplikanti duhet të ketë burime të qëndrueshme dhe të mjaftueshme financimi për të mbajtur aktivitetin e tij gjatë gjithë periudhës gjatë së cilës aksioni po kryhet dhe për të marrë pjesë në financimin e tij. Aplikanti duhet të ketë aftësitë dhe kualifikimet profesionale (teknike dhe menaxheriale) të nevojshme për të përfunduar veprimin e propozuar dhe aftësinë për të menaxhuar një aktivitet të shkallës dhe madhësisë së veprimit.

Kapaciteti financiar i aplikantëve

Aplikantët duhet të tregojnë se kanë kapacitetin financiar dhe aftësinë operacionale për të përfunduar projektin e mbështetur duke dëshmuar të paktën 20.000 Euro si qarkullim vjetor të vitit të kaluar (qoftë përmes deklaratave bankare, Deklarata vjetore e administratës tatimore, raporti i auditimit financiar). Ata duhet të ofrojnë pasqyrat e tyre financiare vjetore që përfshijnë si bilanci, llogaria e fitimit dhe humbjes dhe çdo annex të atyre për vitin e fundit financiar për të cilin llogaritë janë mbyllur.

Aftësitë dhe kualifikimet profesionale

Aplikantët duhet të kenë kapacitetin profesional, teknik, aftësinë operacionale dhe menaxheriale për të përfunduar projektin e propozuar dhe duhet të ofrojnë dokumente mbështetëse, duke vërtetuar se ka të paktën dy punonjës me kohë të plotë (e vërtetuar nga raporti i Listës së Stafit të Administratës Tatimore me CV të detajuara të stafit përgjegjës për realizimin e projektit, përshkrimi i përvojave/anagzhimeve në projekte dhe aktivitete që ndërlidhen me propozim-projektin, të ndërmarra gjatë tri viteve të fundit etj.).

Kriteret e përzgjedhjes do të vlerësohen si hapi i parë nga komisioni i vlerësimit. Mospërputhja me këto kritere do të rezultojë që propozimi të mos vlerësohet më tej nga komisioni vlerësues. Aplikantëve mund t'u kërkohe të japin dëshmi shtesë ose të sqarojnë dokumentet mbështetëse në lidhje me kriteret e përzgjedhjes.

KRITERET KRYESORE TË DHËNIES

Kriteret e renditjes për secilën përzgjedhje do të ndjekin rregullat si në vijim:

Rregulla 1: Aplikimet do të renditen bazuar në pikët e tyre të përgjithshme (shuma e kriterit 1 deri në 3);

Rregulla 2: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 1, ka Aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet aplikimeve që kanë pikë më të larta në kriterin e vlerësimit 1: "objektivat e projektit 'Tourism for Future' dhe ndikimet e pritshme";

Rregulla 3: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 2, ka aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet aplikimeve që kanë pikë më të larta në kriterin e vlerësimit 2: 'Ndikimi';

Rregulla 4: Në rast se pas ndjekjes së Rregullës 3, ka aplikime me të njëjtin poentim, përparësi do t'i jepet atij që është dorëzuar më herët sipas datës së aplikimit.

Përcaktimi i kriterëve	Rezultatet
<p>Kriteri përzgjedhës 1: Respektimi i objektivave të projektit "Tourism for Future" dhe konceptit Eco Label</p> <p>Aplikantët duhet të demonstrojnë një set të qartë objektivash, të cilat janë në linjë me definimin e Objektivave të Tourism for Future veçmas të objektivave të visionit të Eco Label dhe green key eco-tourism</p>	10 pikë
<p>Kriteri përzgjedhës 2: Gatishmëria dhe ndikimi/impakti</p> <p>Aplikantët duhet të demonstrojnë që rezultat e pritshme dhe impakti i Tourism for Future po mbështetet dhe janë inkorporuar fuqishëm në aplikimin për grant, duke u fokusuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Natyrën/ambientin përreth b) Infrastrukture e instaluar operationale (eficiencia dhe kursimi i energjisë dhe ujit, zvoqlimi i mbetjeve c) Furnizimet lokale nga komuniteti përreth, d) Integrimi me trashëgimin kulturore të zones e) Kapacitetet profesionale meaxhuese për turizëm të qëndrueshëm 	20 pikë
<p>Kriteri përzgjedhës 3: Arsyeshmëria e transicionit drejt Qëndrueshmërisë sipas konceptit Eco Label</p> <p>Aplikantët duhet të demonstrojnë evidence kredibile që ekipi i projektit është i zotuar për t'u avancuar/ngritur dhe posedon shkathtësitë e nevojshme, përvojen menaxheriale dhe kapacitetet financiare për të qenë i gatshëm të implementoj grantin e dhëna nga Tourism for Future sipas objektivave të tij</p>	20 pikë
<p>Kriteri përzgjedhës 4: i) Kapacitetet financiare, ii) mundësitë për investime, iii) zotimin e bashkëfinancimit si dhe iv) metodologjinë e menaxhimit të riskut</p>	10
<p>Vërejtje: Aplikantët duhet të demonstrojnë përmes dëshmimeve zyrtare të katër nënkriteret sikur më lartë</p>	Rezultati i përgjithshëm 60 pikë

Propozimet që kanë arritur pikë më të larta në vlerësim do të konsiderohen për financim. Grantet do të jepen brenda kufijve të burimeve buxhetore në dispozicion, duke synuar 10 grante nga rajoni i Pejës dhe 10 grante nga rajoni i Kolasinit.

KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja maksimale e një projekti është 9 muaj.

FINANCIMI DHE PËRQINDJA E BASHKËFINANCIMIT

Projekti Turizmi për të Ardhmen do të financojë pjesën më të madhe të Certifikimit me Standardin Eco-Label me kërkesë për bashkëfinancim nga subjekti afarist i shpërblyer:

Kontributi i bashkëfinancimit përmes TOURISM FOR FUTURE merr formën e një granti dhe është sipas normave minimale dhe maksimale të bashkë-financimit si më mëposht:

Bashkë-financim minimal prej 1.000 Euro

Bashkë-financimi maksimal prej 2.500 Euro

Shënim:

Kontributi i bashkëfinancimit në emër të subjekteve përfituese nga rajoni i Kolashinit do të mbulohet financiarisht nga Komuna e Kolashinit, sipas Shtojcës nr. 01, e hyrë në fuqi më 29 dhjetor 2023.

SHUMA TOTALE E LLOGARITUR E BUXHETIT NË DISPOZICION PËR KËTË THIRRJE

Shuma totale indikative e disponueshme për këtë thirrje është 76.000.00 euro

KUSHTET E PËRGJITHSHME PËR DHËNIEN E GRANTEVE

Kushtet e përgjithshme për dhënien e granteve dhe mënyrat e pagesës janë përcaktuar në modelin e marrëveshjes së grantit.

FORMULARI PËR DORËZIM TË KËRKESAVE PËR GRANT

Aplikimet duhet të dorëzohen duke përdorur sistemin e aplikimit on-line dhe formularët e aplikimit. Udhëzimet se si të plotësohen formularët e aplikimit dhe lidhja me sistemin e aplikimit on-line me formularët e aplikimit janë në dispozicion në platformën elektronike të TOURISM FOR FUTURE:

<https://grante.tourismforfuture.com/en>

Aplikimet që nuk përmbushin këtë kërkesë formale mund të mos vlerësohen më tej.

Data e mbylljes së dorëzimit është 26.01.2024, vetëm aplikimet e pranuar para orës 23:59h (CET).

Aplikimet e dorëzuara pas datës së mbylljes nuk do të merren parasysh.

Aplikantët këshillohen të mos presin minutën e fundit me ngarkimin e formularëve të tyre të aplikimit për të shmangur rrezikun e një paraqitjeje të dështuar për shkak të se sistemi mund të mbingarkohet në orët e fundit para afatit të dorëzimit.

INFORMACION SHITESË

Aplikantët duhet të konsultojnë faqen e internetit të projektit në:

<https://tourismforfuture.com>

Faqja e internetit përmban të gjitha informacionet dhe formularët në lidhje me këtë Thirrje për Propozime, të tilla si udhëzuesi për aplikantët, format e nevojshme për aplikim për granti dhe linkun me platformën e aplikimit online.

ORARI INDIKATIVE:

Data e mbylljes për dorëzimin e aplikacioneve	
Data e parashikuar e përfundimit të vlerësimit	
Data e parashikuar për njoftimin e aplikantëve	
Data e parashikuar për nënshkrimin e kontratave	

Aplikantët e interesuar duhet të dërgojnë aplikimin e tyre, nëpërmjet platformës online, së bashku me dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formulari i aplikimit për grant (platformë online)
- Formulari financiar (platforma online)
- Certifikata e regjistrimit të biznesit, së bashku me setin e informacionit për kompaninë (kodi i aktiviteteve)
- Qarkullimi financiar dhe lista e personelit të regjistruar për vitin 2022 (lëshuar nga administrata tatimore)
- Çdo Certifikim Standard Ndërkombëtar (si ISO etj)
- Kopje e CV-ve të menaxhmentit të projektit
- Përvoja e mëparshme e aplikantit me projektit apo grante të zbatuar në fushën turizmit
- Të dhënat e llogarisë bankare
- Vërtetimi i Administratës Tatimore që dëshmon se nuk ka detyrime apo borxhe
- Të dëshmoj aftësinë për bashkëfinancim

Afati i fundit për pranimin e ofertave është 26.01.2024

Aplikimi duhet të dorëzohet vetëm përmes platformës online: <https://grante.tourismforfuture.com/en>, pas regjistrimit në platformë, duke marrë llogarinë tuaj të përdoruesit të regjistruar

Afati për pyetje do të jetë së paku 10 ditë para afatit të fundit për dorëzimin e aplikacioneve. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet, si dhe njoftimet e tjera të rëndësishme do të publikohen në: <https://tourismforfuture.com>

Pyetjet dhe përgjigjet do të administrohen vetëm me email: info@prishtina-rea.net